

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli:** Konsultim publik për Planin e Përmirësimit të Arsimit Parashkollor për bashkinë Rrogozhinë, për vitin 2025-2027.

**Propozuesi i projektaktit:** Kryetari i Bashkisë Z. Edison Memolla.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin e Përmirësimit të Arsimit Parashkollor për vitin 2025-2027.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Rrogozhinë sipas kalendarit më poshtë:

**Data**           **5 Dhjetor 2024**

**Ora**             **10:00**

**Vendi**           **Qendra Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhine**

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: [visi.shera85@gmail.com](mailto:visi.shera85@gmail.com) dhe [arbendaja67@gmail.com](mailto:arbendaja67@gmail.com)

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë, drejtoret e kopshteve dhe mësueset.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, shoqëria civile, media, në mënyrë të veçantë anëtarë të bordeve dhe këshillave të prindërve dhe kushdo që është i interesuar.
- Zyrat Vendore Arsimore.

**Forma e konsultimit:** Takim në sallën e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit të Përmirësimit të Arsimit Parashkollor të Bashkisë Rrogozhinë, për vitin 2025-2027.
Përshkrimi i çështjes	<p>Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Rrogozhinë dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i shërbimeve në kopshte për të rritur regjistrimet në ato ku ka mungesa.</li><li>• Planifikim strategjik për riorganizimin e infrastrukturës, veçanërisht në kopshtet që ndodhen brenda shkollave apo ato që kërkojnë restaurim urgjent.</li><li>• Zhvillimi i burimeve njerëzore në nivel bashkie për çështje të arsimit parashkollor, duke përfshirë ndërgjegjësimin e drejtuesve dhe administratës për zbatimin e planeve për përmirësim.</li><li>• Krijimi i një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të</li></ul>

	<p>arsimit parashkollor, duke siguruar respektimin e kërkesave ligjore dhe forcimin e kuadrit rregullator për të shmangur shkeljet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe komunitetin për të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e kopshtit në zhvillimin e fëmijëve.</li> </ul>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të specialistes së arsimit në bashki: <a href="mailto:visi.shera85@gmail.com">visi.shera85@gmail.com</a> dhe <a href="mailto:arbendaja67@gmail.com">arbendaja67@gmail.com</a></p> <p><b>BRENDA DATËS 10.12.2024</b></p>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në datën <b>10.12.2024</b>, nëpërmjet adresave të mësipërme;</p> <p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Rrogoshinë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Arsimit, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, Taksave dhe Tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> <li>3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve i çdo rekomandimi dhe opinionit.</li> <li>4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</li> <li>5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar.</li> <li>6. Monitorimi i zbatimit të tij.</li> </ol>
Data e publikimit	15.11.2024